

VENDIM
Nr.639, datë 11.6.2009

PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE TË KRITEREVE TË PËRDORIMIT E TË KONTROLLIT TË FONDIT TË POSAÇËM, NË FUNKSION TË VEPRIMTARISË INFORMATIVE DHE PROCEDURALE PENALE, TË SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.10002, datë 6.10.2008 “Për shërbimin e kontrollit të brendshëm, në Ministrinë e Brendshme”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm (SHKB), në Ministrinë e Brendshme ka dhe përdor fondin e posaçëm të shpenzimeve, në funksion të veprimtarisë informative dhe procedurale penale, brenda fondeve të buxhetit vjetor, miratuar për Ministrinë e Brendshme.

2. Ky fond të përdoret:

a) Në funksion të veprimtarisë informative, që përbëhet nga:

- i) shpenzimet për shpërblimin e personave, që bashkëpunojnë me SHKB-në;
- ii) shpenzimet për sigurimin e informacionit;
- iii) shpenzimet për blerje e shërbime të drejtpërdrejta, të mjeteve e të pajisjeve;
- iv) shpenzimet për marrje me qira të objekteve dhe të mjeteve;
- v) shpenzimet për kryerjen e testit të integritetit.

b) Në funksion të veprimtarisë procedurale penale, që përbëhet nga shpenzime për oficerin dhe agentin e Policisë Gjyqësore ose personin e autorizuar, gjatë kryerjes së operacioneve, ku përdoren teknika të posaçme hetimi (përgjime, veprime të simuluar dhe infiltrim).

3. Vlera e fondit të posaçëm është 15 për qind e vlerës së buxhetit vjetor të SHKB-së.

4. Kontrolli për shpenzimet e kryera nga fondi i posaçëm ushtrohet, jo më pak se një herë në vit, nga personat e autorizuar nga ministri.

5. Ngarkohet Ministri i Brendshëm për nxjerrjen e udhëzimit përkatës, për përcaktimin e procedurave të hollësishme, që duhen zbatuar, dhe të dokumentacionit që duhet hartuar për përdorimin e këtij fondi.

6. Ngarkohet Ministri i Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha